

“Bukuria e shpirtit, çelësi i përmirësimit të shoqërisë”

Do të më pëlqente sikur bota të ishte e aftë të kuptonte ndjenjat, pasi nëse kupton ndjenjat kupton njerëzit dhe kur kupton njerëzit përmirëson botën. Sa e sa probleme do të zgjidheshin, nëse njerëzit arrinin të kuptonim ndjenjat e njëri-tjetrit! Por ja që këto fjalë nuk janë realiteti. Shoqëria në të cilën jetojmë është krejt ndryshe nga ëndrrat tona më të bukura.

E veçanta jonë si njerëz është fakti që të gjithë jemi të ndryshëm, jo vetëm nga pamja, por edhe nga një aspekt tjetër, edhe më të thellë, më të veçantë siç është shpirti. Shpirti është kaq autentik, kaq kompleks sa asnjëri prej nesh nuk mund të gjykojë dot mbi bukurinë, apo shëmtinë e tij. Ngrië kokën lart, shiko qiellin e kaltër. Me siguri retë kanë krijuar forma nga më të ndryshmet. Asnjë re nuk është identike me tjetrën, ashtu si nuk mund të jetë kurrë një njeri i njëjtë me dikë tjetër.

Mirëpo problemi i njeriut është tepër i çuditshëm, gati satirik. Njëlloj siç fluturat nuk shohin dot krahët e tyre, njeriu e ka shumë të vështirë të njohë bukurinë e tij. Ai sheh bukurinë që e rrethon, admiron të bukurën te të tjerët, por kur vjen puna te vetja e tij përpiqet, stërmundohet dhe megjithatë nuk gjen asgjë që t’i bëjë përshtypje. Kjo çon në një sërë problemesh që do të lenë brenga në shpirtin njerëzor.

Gjatë jetës, për arsye nga më të ndryshmet dikujt mund t’i krijohet ideja se nuk është i bukur, i veçantë, apo mjaftueshëm i mirë për njerëzit që e rrethojnë. Ai nuk e sheh dhe nuk arrin dot ta njohë bukurinë e tij. Kështu, ngadalë, në një mënyrë apo në një tjetër, perceptimi i tij mbi veten kthehet në imazhin që ka bota për të. Bota, si një vend i egër, i cili përbehet nga njerëz që po ashtu nuk arrijnë të njohin bukurinë e vetes së tyre, i vendoset kundër. Pse? Kjo për shkak se pasiguria çon në smirë, inat, zili. Njerëzit fillojnë të mendojnë se duke ulur vlerat e dikujt, do të nxjerrin në pah vlerat e tyre, gjë që është krejtësisht e gabuar.

Forma më e thjeshtë, më e drejtpërdrejtë që merr ky fenomen është bullizmi. Më vjen keq kur mendoj se në shoqërinë ku jetoj ka vajza e djem që përballen me shtypje dhe keqtrajtim. Kjo, vetëm për shkak të pasigurisë ushqehet nga mendje të tronditura te shpirtit të dërrmuar. Sa e sa prej nesh shohin ngacmime, presione dhe dhunë të shpërndarë si pasojë e kësaj sjelljeje të turpshme, që vesh me hipokrizi moralin e shoqërisë njerëzore?! Dhe çfarë zgjedhim ne të bëjmë? Ne heshtim, kthejmë kokën nga ana tjetër, me shpresën se do të ndihemi më të qetë; sikur po nuk e pamë problemin, ai nuk do të arrijë te ne.

Por prit! Po sikur ta nisim nga e para? Po sikur ne, në vend që të ndiejmë turp për pasiguritë tona, t’i përqafojmë ato dhe të krenohemi për bukurinë e shpirtit tonë? Po sikur ne si shoqëri në vend që të kthejmë kokën nga ana tjetër tek shohim vuajtjet e të tjeëve, të afrohem, ta prekim problemin dhe të sjellim ndryshimin?

Thjesht imagjino sa më e thjeshtë do të ishte sikur familja të ushqente moralin, komunikimin dhe vetëbesimin te fëmija. Tekefundit, familja është vendi ku nguliten vlerat themelore të njeriut. Familja është ajo që duhet t’i mësojë fëmijës të dojë veten, të kuptojë se sa i veçantë, sa i bukur është shpirti i tij. Të jesh prind do të thotë të komunikosh me fëmijët e tu, të

jesh i pari, të cilit fëmija do t'i rrëfejë jo vetëm arrijtjet më të mëdha , por edhe problemet më shqetësuese. Prandaj po, familja bart peshën më të madhe në gjithçka.

Nelson Mandela ka thënë: “Shkolla është arma më e fortë që ne mund të përdorim për të ndryshuar shoqërinë “, dhe unë bie plotësisht dakord me të. Bankat e shkollës nuk shërbejnë vetëm për të mësuar; shkolla mban përgjegjësinë kryesore për të edukuar shoqërinë e së ardhmes. Qëllimi më i rëndësishëm i mjediseve arimore duhet të jetë në radhë të parë të promovojë vlerën, të mirën te nxënësit. Por dhuna dhe ngacmimet qëndrojnë shumë larg një qytetari të denjë të së ardhmes. Për këtë arsye shkolla duhet të jetë ajo që merr masa kundër bullizmit. I gjithë stafi mësimdhënës duhet të ndodhet pranë nxënësve, t'i konsultojë dhe të mos lejojë degradimin e situatës në bullizëm.

Unë mendoj se shoqëria do të njohë përmirësimin, vetëm atëherë kur ajo të jetë e aftë të trajtojë si duhet problemet e saj. Armiku më i madh i përmirësimit është indiferenca. Në momentin që njerëzit zgjedhin heshtjen, shoqëria ka marrë fund. Prandaj, ju lutem, mos qëndroni pasivë, të heshtur kundrejt shfofmimit të vlerave, degradimit të shoqërisë. Është në dorën tonë të ngremë zërin, është në të mirën tonë të bëjmë qoftë edhe minimumin për të përmirësuar realitetin, në të cilin do të jetojnë fëmijët tanë.

Do të më pëlqente sikur bota të ishte e aftë të kuptonte ndjenjat, pasi nëse kupton ndjenjat kupton njerëzit dhe kur kupton njerëzit përmirëson botën. Le të lejojmë ndjenjat tona njerëzore të na udhëheqin drejt së mirës, së bukurës, drejt një bote të denjë, ku shpirti i gjithsecilit prej nesh gjen paqe. Le ta duam njëri-tjetrin ashtu siç jemi, të bukur dhe të veçantë, njëlloj si retë që shohim në qiell.

Punoi: Elena Gorari, XA, kolegji “Preca”, Korçë